



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 3500 Prot

Vlorë, më 20/12/2017

VENDIM

Nr. 36, datë 20/12/2017

PËR VENDOSJEN E ESHTRAVE TË “DËSHMORIT TË ATDHEUT” XHEVDËT QERIM SHAKOHOXHAJ, NË VARREZAT E DËSHMORËVE TË ATDHEUT TË QYTETIT TË VLORËS

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 20/12/2017 në zbatim të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“, Ligjit Nr.8607 datë 27/04/2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.151, datë 25.04.2002 “Për Statusin Dëshmor i Atdheut” i ndryshuar si dhe kërkesës së familjarëve të “Dëshmorit të Atdheut” **Xhevdet Qerim SHAKOHOXHAJ**, protokolluar me tonën Nr. 2683 Prot, datë 29.09.2017;

VENDOSI;

1. Të bëhet zhvendosja e eshtrave të “Dëshmorit të Atdheut” **Xhevdet Qerim SHAKOHOXHAJ (1926- 1944)**, i shpallur i tillë me Vendimin Nr.106, datë 21.12.2007 nga Komisioni Qëndror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” nga fshati Vranisht dhe vendosja e tyre në varrezat e “Dëshmorëve të Atdheut” të qytetit të Vlorës.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari, Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve pranë Këshillit të Qarkut Vlorë.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

